



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË**

Numri i lëndës: 2024:080938

Datë: 26.04.2024

Numri i dokumentit: 05625860

K.DH.SH.II.nr.1572/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Dren Rogova, në çështjen përmbartimore të kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESCO), me nr. Biznesi 71102130, me seli ne Prishtinë Bulevardi “Bill Klinton” nr.5, ndaj debitorit D.P.T “ADES” me seli ne Malishevë rr. “Rilindja Kombëtare”, me bazë juridike përmbartimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.307/22, të datës 27.09.2023, me datë 26.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e kreditorit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESCO), me nr. Biznesi 71102130, me seli ne Prishtinë Bulevardi “Bill Klinton” nr.5, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.307/22, të datës 27.09.2023, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës se Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.307/22, të datës 27.09.2023, e ka pranuar si të bazuar prapësimin e debitorit D.P.T “ADES” me seli ne Malishevë rr. “Rilindja Kombëtare”, dhe urdhrin përmbartimor P.nr.1241/19 dt.20.12.2019, te lejuar nga Përmbartuesi Privat Gjokë Radi me seli ne Gjakovë, e ka anuluar ndërsa ka përfunduar procedurën ne këtë çështje përmbartimore.

Kundër këtij aktvendimi, ne afat ligjor, ka ushtruar ankesë kreditori, për shkak të shkeljeve thelbësore te dispozitave te procedurës kontestimore dhe përmbartimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të se drejtës materiale, me propozim që Gjykata e shkallës së dytë, ta aprovojë si të bazuar ankesën e kreditorit, aktvendimin e ankimuar ta prish dhe çështjen ta kthej ne shkallë te parë ne rishqyrtim dhe rivendosje.

Përgjigje ne ankesën e kreditorit ka paraqitur debitori, me arsyetimin se e kundërshton ankesën e kreditorit sipas te gjitha bazave juridike, si te pabazuar, propozon qe gjykata e shkallës së dytë ta refuzoj te njëjtën si te pabazuar dhe joligjore.

Dhoma e shkalles se dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike Sh.a (KESCO), me seli ne Prishtinë Bulevardi “Bill Klinton” nr.5, me datën 20.12.2019, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit D.P.T “ADES” me seli ne Malishevë rr. “Rilindja Kombëtare”, në bazë te dokumentit te besueshëm - Ekstraktit të verifikuar nga librat afariste DGJ -.... Përmbartuesi Privat Gjokë Radi nga Gjakova, sipas propozimit të kreditorit, ka nxjerrë Urdhrin Përmbartimor P.nr.1241/19 dt.20.12.2019, me të cilin e ka detyruar debitorin qe kreditorit, ne emër te borxhit për konsum te energjisë elektrike, ne afat prej 7 ditësh ti paguaj shumen prej 742.07 euro, për periudhën prej 22.06.2019 deri me datën 07.12.2019 , me kamatë prej 8% nga dita e kalimit te afatit për pagesë e deri ne pagesën definitive te borxhit.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim me datën 22.01.2020, me pretendimin se për periudhën kohore te cekur nga kreditori nuk ka zhvilluar asnjë aktivitet biznesor sepse biznesin ne Malishevë e ka mbyllur me datën 14.10.2008 dhe e ka hequr njehsorin elektrik nga lokali, njehsori elektrik qe ka qenë i instaluar deri sa ka zhvilluar aktivitetin ka pasur nr.265118 ndërsa shifra e debitorit ka qene DPZ-9033009. Arsyeton se njehsorin e përdorur deri sa ka zhvilluar aktivitete, e ka hequr kur e ka mbyll aktivitetin ne Malishevë dhe për këtë sjell si provë procesverbalin e hartuar nga komisioni i dt.14.10.2008 dhe dt.23.09.2008 si dhe deklaratën e pronarit te lokalit H.M. Malishevë dt.20.01.2020. Pra te dhënat ne dokumentin e kreditorit janë kontestuese sa i përket numrit te njehsorit elektrik 35012277, shifra e konsumatorit DGJ-... janë te dikujt tjetër, propozon qe gjykata ta aprovoj ne tërësi prapësimin e debitorit ndërsa te gjitha veprimet e ndërmarra deri me tani te abrogohen.

Ndaj prapësimin te debitorit, kreditori me datën 03.03.2020 ka ushtruar përgjigje, me arsyetimin se propozimi për përmbartim është bere për periudhën 22.06.2019 deri me datën 07.12.2019, shton se debitori ka bere disa pagesa ne vlera te ndryshme dhe konfirmon se debitori ex-lege debitori ka shkaktuar ndërprerjen e parashkrimit, andaj konsideron se prapësimi i debitorit është i pabazuar ndërsa propozon qe gjykata urdhrin përmbartimor ta vërtetoj.

Gjykata e shkallës së parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes ne prapësim, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.307/22 dt.27.09.2023, ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit dhe ka anuluar urdhrin përmbartimor, duke vendosur kështu si ne dispozitiv te aktvendimit. Ne arsyetim te këtij aktvendimi gjykata e shkalles se parë ka theksuar se prapësimi i debitorit është i bazuar andaj edhe urdhri përmbartimor duhet te anulohet. Gjykata i referohet nenit 29 par.1 nen par. 1.3 si dhe nenin 37 te LPP duke konstatuar se ekstrakti i nxjerr nga librat afarist te kontabilitetit mbi bazën e te cilit është lejuar përmbartimi nuk i plotëson kushtet për te qenë dokument i besueshëm sepse i njëjti i është bashkangjitur propozimit ne kopje dhe jo ne original apo kopje te vërtetuar andaj si i tillë është ne kundërshtim me nenin 38 par.1 te LPP.

Gjykata i referohet edhe nenit 43 par.4 te LPP dhe ne pajtim edhe me nenin 71 dhe 73 e nenin 12 te ligjit nr.05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 04/L-137 te Procedurës Përmbartimore ka vendosur si ne dispozitivi te vendimit te saj.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Dhoma e shkalles se dytë e Gjykatës Komerciale, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore, Aktvendimi i atakuar rezulton të mos jetë përfshirë as me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, të LPK-së dhe as ne shkelje lidhur me zbatimin e të drejtës materiale për të cilat Gjykata e shkalles se dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Ne lidhje me çështjen ne procedurë, gjykata e shkalles se dytë vlerëson se aktvendimi i atakuar është marrë pas vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, të cilat kanë mbështetje në shkresat e lëndës dhe në ligj sepse edhe për këtë gjykatë dokumenti gjegjësisht ekstrakti i verifikuar nga librat afariste te kontabilitetit me nr. DGJ -... mbi bazën e te cilit është lejuar përmbartimi, nuk plotëson kushtet ligjore për te qenë dokument i besueshëm sepse nuk është ne pajtim me dispozitat ligjore përkatësisht nenin 29 par.1 nenpar.1.2 dhe par.3 te LPP, pasi propozimit për përmbartim i është bashkangjitur ne kopje dhe jo origjinal apo kopje e vërtetuar siç parashohin dispozitat ligjore, andaj si i tille nuk paraqet bazë juridike për lejimin e përmbartimit. Po ashtu gjykata e shkallës se dytë vlerëson se bazuar ne shkresat e lendes rezulton se ne mes te dokumentit mbi bazën e te cilit është lejuar përmbartimi dhe provave ne lëndë te cilat debitori ua bashkëngjiti prapësimi gjegjësisht Procesverbaleve nr.1854 dhe 164618, lëshuar nga Departamenti i Distribuomi-KEK ne Prizren, rezulton se këto te dhëna ne lidhje me debitorin janë kontradiktore me te dhënat e ofruara nga kreditori ne propozimin për përmbartim dhe dokumentin e bashkëngjitur këtij propozimi e kjo pikërisht me te dhënat për njehsorin i cili ne procesverbalin nr.1854 rezulton me numër 265118 dhe shifër te konsumatorit nr. 9033009 ndërsa dokumentin mbi te cilin është lejuar përmbartimi numri i njehsorit është 35012277 ndërsa shifra e konsumatorit është DGJ-....

Marrë parasysh këtë gjendje faktike, kjo gjykatë vlerëson përfundimin juridik te gjykatës se shkalles se parë dhe merr parasysh nenin 43 par.4 te LPP i cili parasheh qe *“Përmbartuesit privat nxjerrin urdhrin për përmbartueshmëri në rastet që ligjërisht prezantohen para tyre të cilat përmbushin kushtet për përmbartueshmëri. Në lidhje me ankesën që ngrehë kundërshtimin ndaj urdhrit të përmbartueshmërisë së nxjerrë nga përmbartuesi privat, Gjykata që kryen rishikimin e procedurës së përmbartimit rishikon nëse janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e atij urdhri nga përmbartuesi privat. Nëse Gjykata përcakton se nuk janë plotësuar kushtet për nxjerrjen e urdhrit për përmbartim nga përmbartuesi privat, Gjykata shfuqizon urdhrin me vendim”*.

Po ashtu kjo gjykatë i ka analizuar pretendimet e kreditorit por konsideron se nuk qëndrojnë, te njëjtat nuk janë relevante për një vendosje ndryshe, sepse ne rastin konkret kreditori nuk ka ofruar prova ne mbështetje tyre, ashtu qe vendosi qe ti refuzoj si te pabazuara ndërsa aktvendimin e atakuar ta vërtetoj.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 209 par.1pika (b) te LPK lidhur me nenin 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika b), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr. 1572/23, me datë 26.04.2024

Gjyqtari
Dren Rogova